



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 33

Prishtinë, më 28. 04. 2009, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -203

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujovic, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi dhe Vezira Emrush – anëtarë.

**Mungoi:** Shpresa Murati.

**Të ftuar:** Muhamet Shala dhe Ramadan Ademi.

**Mbledhjen e mbikëqyrën:** Rrezarta Ahmeti - KDI, Blerina Uka – NDI, Besarta Bytyçi - "Zëri" dhe Petrit Hysa – OSB.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator dhe zyrtar i lartë dhe Visar Krasniqi - zyrtar ligjor.

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
2. Dëgjimi i Muhamet Shalës lidhur me ankesën që ka të bëjë me çështje banesore,
3. Dëgjimi i R. A, që ka të bëjë me zbatimin e të gjeturave të avokatit të popullit lidhur me cenimin e të drejtave të punëtorëve të kombinatit "Trepça" në Mitrovicë,
4. Të ndryshme.

*Rendi i ditës u miratua.*

**Kryetari** konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë.

## 1 . Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

**Kryetari** konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

## 2. Dëgjimi i Muhamet Shalës lidhur me ankesën që ka të bëjë me çështje banesore

**Ismet Beqiri** – E përshëndeti prof. Muhamet Shalën, e njoftoi për ankesën që ka të bëjë me kontest banesor dhe e ftoi ta merrte fjalën.

**Muhamet Shala** – Falënderoi Komisionin për mundësinë që ia ofroi të paraqitej. Para vetes kishte një dosje voluminoze për historinë e ankesës që filloi në mars të vitit 2003, kur HABITAT-i atëherëshëm e nisi procedurën për kontestimin e pronësisë së banesave që Rektorati ua kishte ndarë në vitin 2000 profesorëve të pastrehë e që pas përfundimit të luftës kishin nevojë për ndihmë institucionale. Theksoi se banesa kishin marrë Hajredin Kuqi, Arsim Bajrami dhe Bajram Nura. Sipas Muhamet Shalës procedura e HABITAT-it zbatohet vetëm ndaj tij dhe e kishin dëbuar nga banesa. Shtoi se personat e lartpërmendur i kishin blerë këto banesa. Ai nuk pati mundësi ta blinte banesën, sepse kishte marrë sugjerime nga avokatët të mos hidhte "para në baltë", sepse fjala ishte për pronë të Universitetit. Në korrik të vitit 2008, ish-Bordi i UP-së mori vendim arbitrar dhe ndau troje në Lagjen e Universitetit për ndërtimin e shtëpive private për ish-udhëheqësit e Rektoratit të UP-së. Këto troje iu dhanë po këtyre personave, që u përmendën më lart, që kishin edhe banesa më parë po në këtë lagje. Shtoi se kësaj liste iu bashkëngjiten edhe profesorët: Selim Daci, Musli Bajraktari dhe Fejzullah Krasniqi, të cilët kishin edhe banesa private në Prishtinë. Ndarjen e këtyre banesave, Shala e trajton të kundërligjshme, jo transparente dhe me parregullsi të shumta nga Rektorati i Universitetit.

Tha se deri tani nuk ishte trajtuar njësoj dhe ishte diskriminuar. Kërkoj nga Komisioni që këtë çështje të ngrejë në një dëgjim publik. Përsëriti se në banesën e përmendur nuk kishte hyrë arbitrarisht, por iu kishte dhënë me vendim të veçantë të Rektoratit.

Që të mos mbetet problem vetëm i tij kërkoi që këtë çështje ta marrë përsipër Universiteti dhe ligjërisht t'i qartësojë gjërat deri në fund.

**Ismet Beqiri** – kryetar - Theksoi se përgjigjja do t'i jepet profesorit në mbledhjen e radhës të Komisionit. Shtoi se në fillim duhet ta dëgjojmë Agjencinë e Pronës të Kosovës, pastaj nëse paraqitet nevoja edhe rektorin e UP-së". Sa i përket tjetërsimit të pronës, nga shumë funksionarë të tanishëm, kjo çështje nuk i takon fushëveprimit të këtij komisioni. Prona, në Kosovë, është çështje madhore dhe mund të trajtohet në Kuvend

**Naim Rrustemi** – Vuri në pah se profesori e ka ngritur një çështje me interes, që duhet të shqyrtohet brenda suazave të dispozitave ligjore.

**Ibrahim Makolli** – Ishte i mendimit se në rastin konkret fjala është për dy çështje: A do të debatohet për shpronësim të tokës, apo për rastin individual? Nëse është tjetërsuar prona në mënyrë të kundërligjshme, atëherë ka shkelje të të drejtave. Nëse veprimi i tjetërsimit të pronës është i ligjshëm, atëherë nuk mund të flasim për shkelje të të drejtave të njeriut, gjegjësisht për aplikuesin që nuk e ka fituar këtë të drejtë. U pajtua që të ftohen përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare të Pronës dhe të Rektoratit.

**Sanije Alijaj** – Ankesën e vlerësoi si shkelje të së drejtës individuale. U pajtua të ftoheshin përfaqësuesit e HABITAT-it dhe përfaqësuesi i Universitetit të UP-së që të ballafaqohen vendimet e tyre. Komisioni mund të bëjë mocion, nëse konsiderohet se është tjetërsuar prona.

*Pas diskutimeve lidhur me shkresën e Muhamet Shalës, Komisioni nxori këtë*

### ***Përfundim***

Komisioni vendosi që më 12. 5. 2009 të mbajë mbledhje në të cilën do të ftoheshin përfaqësuesit e institucioneve:

1. Përfaqësuesi i Rektoratit të UP-së dhe
2. Përfaqësuesi i Agjencisë së Pronave të Kosovës (ish-HABITAT-i).

**3. Dëgjimi i R. A që ka të bëjë me zbatimin e të gjeturave të avokatit të popullit lidhur me cenimin e të drejtave të punëtorëve të kombinatit “Trepça” në Mitrovicë**

**Kryetari** - E përshëndeti kryetarin e Sindikatës së Pavarur të kombinatit “Trepça”, që do ta njoftonte Komisionin për problemet me të cilat ballafaqohen punëtorët, si dhe për raportin e avokatit të popullit të 9. 2. 2009. E ftoi ta merrte fjalën.

**Ramadan Ademi** – Paraqiti një kronologji të gjendjes së mjerueshme që është krijuar në kombinatin “Trepça”. Kjo gjendje vazhdon të jetë e tillë edhe sot e kësaj dite. I paraqiti shqetësimet e 10,734 punëtorëve, të cilët janë diskriminuar në të gjitha format. Kjo shihet edhe nga raporti i avokatit të popullit të 9. 02. 2009. Duke i paraqitur shqetësimet e këtyre njerëzve tregoi se çka po ndodh me Mitrovicën, ku me privatizim të egër me mija punëtorë kanë mbetur në rrugë. Deri tani punëtorët nuk i kanë marrë 20%, as rrogat. Kështu vazhdimisht u janë shkelur të drejtat. Prej vitit 2004 nuk ka institucion që nuk iu kemi drejtuar, duke filluar nga Kuvendi komunal e deri te Presidenca. Nga Komisioni kërkoi ta ngrejë këtë çështje dhe ta ofrojë një përgjigje. Privatizimin e Xeherores e vlerësoi të dëmshëm. Kërkoi të mos privatizohet dhe të shpallet pasuri kombëtare.

**Ibrahim Makolli** – Kritikat për privatizimin ua drejtoi partive që ishin në Qeveri dhe në Kuvend, sepse tjetërsimi dhe abuzimi i pronës së “Trepçës” po bëhen tash e 10 vjet. Ç'bënë Qeveria dhe Kuvendi?

**Naim Rustemi** – Tha se çështja e “Trepçës” është rregulluar me një Rregullore të veçantë të përfaqësuesit special. AKM-ja nuk ka pasur të drejtë ta menaxhonte pronën e “Trepçës”. Shtoi se ishin identifikuar 36 organizata të kompleksit “Trepça”. Në listën e nënshkruar shihet se me rregullore të veçantë AKM-ja ka qenë e privuar nga e drejta e ushtrimit të funksioneve.

**Nerxhivane Dauti** – I propozoi Komisionit që shqetësimin e punëtorëve të “Trepçës”, ta caktonte pikë të rendit të ditës dhe rekomandimet t’ia dërgojë Kuvendit, me qëllim që për këtë çështje të debatohet.

*Pas një debati të gjerë dhe konstruktiv lidhur me këtë pikë Komisioni nxori këtë*

### *P e r f u n d i m*

*Komisioni vendosi që në maj 2009 të mbajë dëgjim publik lidhur me gjendjen punëtorëve të “Trepçës”.*

#### **4. Të ndryshme.**

Kryetari i njoftoi anëtarët se më 12. 5. 2009, Komisioni do ta ketë në shqyrtim letrën e bardhë” **“SFIDAT E PËRFSHIRJES SOCIALE NË KOSOVË”**. Arsyetimin e mbështeti se nuk ishin të përgatitur për të nxjerrë rekomandime përkatëse.

Mbledhja përfundoi ne orën 15,00

Kryetari i Komisionit  
Ismet Beqiri

-----